

Znj. Valbona Gaxha është diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën Administrim Biznesi, dhe më pas ka ndjekur studimet pasuniversitare të nivelit master në “Ekonomi të Zbatuar”, pranë Institutit për Studime të Avancuara në Vjenë, Austri (1995). Në vitin 2008 është diplomuar në Master shkencor në “Kontabilitet dhe Auditim” pranë Universitetit të Tiranës, ku në vazhdim është kandidate për titullin Doktor në Financë, Strategji Biznesi dhe Kontabilitet.

Znj. Gaxha është e certifikuar si kontabiliste publike nga Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar Publik (CPA) në Ontario, Kanada (2016), dhe si audituese ligjore nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në vitin 2018.

Znj. Gaxha prej vitit 2018 është pjesë e stafit të KLSH në pozicionin e Kryeaudituesit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit më pas si Drejtor i këtij Departamenti.

Znj. Gaxha aktualisht mban pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në KLSH.

Ajo ka qenë në pozicione drejtuese në sektorin privat dhe publik në Shqipëri si Autoriteti i Konkurrencës, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, Raiffeisen Leasing sh.a, Landeslease sh.a. Gjithashtu, znj. Gaxha ka një eksperiencë 10 vjeçare profesionale në kontabilitet dhe financë, në Toronto- Kanada pranë disa kompanive private përfshirë sektorin financiar.

Gjatë karrierës së saj, ajo ka qenë pjesë e trupës pedagogjike në Fakultetin Ekonomik si asistente pedagoge në departamentin e kontabilitetit, si dhe ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme në fushën financiare dhe të auditimit.